

Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente	13
Aneks	13

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.
1.3. Personi i kontaktit	Flutura Braçaj
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Pergjegjës, Sektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	fbracaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	03.07.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	03.07.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	03.07.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Objektivi kryesor i mbledhjes së të dhënave të çmimeve është llogaritja e treguesit tremujor të Çmimeve Absolute dhe Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore. Këto janë treguesit kryesor që matin ndryshimet e çmimeve të produkteve bujqësore në nivel vendi dhe mundëson krahasimin e tyre me shtete e tjera. Këto të dhëna japin informacion mbi ecurinë e çmimeve për prodhimet bimore, prodhimet e blegtorisë dhe produkteve të tjera blegtorale gjatë një periudhe të caktuar kohe. Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore llogariten duke përdorur “çmimet e prodhimit”, të grumbulluara në ferma, duke përjashtuar taksat. Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore llogariten bazuar në standardet dhe rregullat e përshkruar në : 2020 - Handbook on Agricultural Product and Input Price Statistics (europa.eu)

3.2. Sistemi i klasifikimit	Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore llogaritet dhe publikohet sipas strukturës së klasifikimit të produkteve bujqësore, i përputhshëm plotësisht me strukturën që përdor EUROSTAT. Bazuar në këtë klasifikim çmimet janë klasifikuar në 11 grupe kryesore si: I Prodhimet bimore 1. Drithëra; 2. Bimë Industriale; 3. Bimë foragjere; 4. Perime; 5. Patate; 6. Prodhimet e drufrutorëve; 6.1 Fruta; 6.2 Agrume; 6.3 Rrush; 6.4 Ullinj. 7. Verë; 8. Vaj Ulliri; II Prodhimet e blegtorisë 9. Mish peshë e gjallë; 9.1 Gjedhi; 9.2 Derra; 9.3 Të imta; 9.4 Shpendë; 10. Qumësht; 10.1 Qumësht lope; 10.2 Qumësht të tjerë; 11. Produkte të tjera blegtorale; 11.1 Vezë; 11.2 Mjaltë.
3.3. Mbulimi i sektorit	Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore mbulon të dhënat për fermat bujqësore dhe blegtorale, tregjet e gjësë së gjallë, tregjet e shumicës dhe vende të tjera ku prodhimet bujqësore mund të grumbullohen. Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore japin informacion statistikor mbi: • Indeks të tremujor të çmimeve të prodhimeve bujqësore; • Indeks të vjetor të çmimeve të prodhimeve bujqësore.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të produkteve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore: Për prodhimet bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë industrial, bimë foragjere, perime, patate dhe drufrutorët. Prodhimet blegtorale: Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe për prodhimet blegtorale. Çmimet grumbullohen për katër kategori kryesore të kafshëve: gjedhi, të imta, derra dhe shpendë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për kategoritë: qumësht, vezë dhe mjaltë.

	Indeksi: Indeksi llogaritet dhe publikohet sipas strukturës së klasifikimit të produkteve bujqësore, i përputhshëm plotësisht me strukturën që përdor EUROSTAT. Bazuar në këtë klasifikim çmimet janë klasifikuar në 11 grupe kryesore si: • Drithëra; • Bimë Industriale; • Bimë foragjere; • Perime; • Patate; • Prodhimet e drufrutorëve; • Verë; • Vaj Ulliri; • Prodhim mishi peshë e gjallë; • Qumësht; • Produkte të tjera blegtorale.
3.5. Njësia statistikore	Të dhënat i referohen prodhimeve bimore, blegtorisë dhe produkteve të tjera blegtorale.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore e synuar në Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore janë çmimet në nivel ferme për produktet vendase, duke përfshirë taksat. Popullata statistikore e synuar janë: • Fermat bujqësore dhe blegtorale; • Tregjet e gjelbërta; • Tregjet me shumicë; • Tregjet e gjësë së gjallë dhe thertoret; • Komplekset e pularive dhe të vezëve.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore mbulojnë të gjithë territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2015 e në vazhdim për: • Indeksin tremujor të çmimeve të prodhimeve bujqësore. Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2016 e në vazhdim për: • Indeksin vjetor të çmimeve të prodhimeve bujqësore.
3.9. Periudha bazë	Periudha referuese (bazë) për Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore është (2015=100)

4. Njësia matëse	Njësitë matëse janë në: lekë, kg, litër sipas produktit.
5. Periudha e referencës	Periudha e referencës për të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore është 31 Dhjetor 2024. Ky raport i referohet vitit 2024.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e Statistikave të Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore konsiston në: • Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare"; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026. Bazat ligjore përkatëse në nivel Evropian konsiston në: • 2020 - Handbook on Agricultural Product and Input Price Statistics (europa.eu)
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore transmetohen në EUROSTAT nëpërmjet pyetësorit.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrotja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të

	dhënave; Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësive statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e web të INSTAT. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: 1. Website - online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimet specifike; 4. Seksioni kërkesa të dhënash.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Rezultatet e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore publikohen në baza vjetore.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp për Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë si: indeksi, ndryshimi vjetor, ndryshimi tremujor etj. Formatit i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos dhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp për Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.

10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT. Rezultatet e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore janë botuar nën temën: • Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore
10.3. Baza e të dhënave on-line	Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun: databaza statistikore
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat për Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për: kontakt
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Spektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “ Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018 ”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: përgjegjëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha.

12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e të dhënave të Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore ndahen në përdorues të brendshëm dhe të përdorues të jashtëm: ➤ Përdorues të jashtëm • Institucionet e administratës publike; • Universitetet; • Organizata jofitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Bizneset; • Studiuesit, studentët dhe grupe të tjera të ngjashme. ➤ Përdorues të brendshëm: • Drejtoria e Llogarive Kombëtare; • Drejtoria e Statistikave Sektoriale të cilët përdorin statistikën e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore si input në punën e tyre.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve. Rezultatet e vërtetimit për 2024 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore" është vlerësuar me 3.81 pikë (76.2%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave mbi "Indeksin e Çmimeve të Produkteve Bujqësore" gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloret të ndjekura. Shkalla e Plotshmërisë së të dhënave të "Indeksit të Çmimeve të Produkteve Bujqësore" për 2024 do të llogaritet nga EUROSTAT.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton institucionet përkatëse dhe sektorët brenda INSTAT për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm. Saktësia e përgjithshme konsiderohet e mirë.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet për këtë aktivitet statistikor, pasi Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore është i bazuar në kampion jo-probabilistik. Për të reduktuar gabimet, mbledhen sa më shumë çmime.
13.3. Gabim jo i kampionimit	Gabimet jo të kampionimit janë kryesisht gabime që ndodhin gjatë matjeve ose refuzimeve. Këto gabime vlerësohen dhe krahasohen me rezultatet e periudhave të mëparshme. Për të marrë informacionin korrekt dhe për të rritur normën e përgjigjeve, fermat bujqësore dhe vendet ku grumbullohen çmimet

	rikontaktohen me telefon ose drejtpërdrejt. Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë feramat bujqësore dhe vendet ku grumbullohen çmimet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur feramat bujqësore dhe vendet ku grumbullohen çmimet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore publikohen në faqen e internetit të INSTAT 184 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+184 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave për Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore është data 31 Dhjetor 2024. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>7/3/2025</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>184</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024	Data e publikimit	7/3/2025	Afatet kohore	184		
Periudha referuese	12/31/2024								
Data e publikimit	7/3/2025								
Afatet kohore	184								
14.2. Përpikmëria	Të dhënat për Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore publikohen në kalendarin e publikimeve. Publikimi për Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>7/3/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>7/3/2025</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024	Data e shpallur	7/3/2025	Data e publikimit	7/3/2025	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2024								
Data e shpallur	7/3/2025								
Data e publikimit	7/3/2025								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria									
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore llogariten bazuar në standardet dhe rregullat të përshkruar në Manualin e Çmimeve të Produkteve Bujqësore të Eurostat dhe janë të krahasueshme me të gjithë vendet europiane që raportojnë të dhënat për Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore në Eurostat.								
15.2. Krahaseshmëria kohore	Të dhënat mbi Indeksin tremujor të çmimeve të prodhimeve bujqësore datojnë që nga viti 2015 deri në 2024 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 10 vitesh ($CC2=Jlast-Jfirst+1=10$). Të dhënat mbi Indeksin vjetor të çmimeve të prodhimeve bujqësore datojnë që nga viti 2016 deri në 2024 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 9 vitesh ($CC2=Jlast-Jfirst+1=9$). Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.								
15.4. Koherenca e brendshme	Në vlerësimin e output-it kontrollohet konsistenca e brendshme e të dhënave para se output-i të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave								

	dhe koherenca në seri e tyre. Gjithashtu bëhen kontrolle më të detajuara në nivel makro.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave mbi Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore është: • 1 specialist pranë zyrave qendrore të INSTAT, në sektorin e Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis; • 14 anketues; • 2 kontrolllore.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë: • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se autoritetet lokale që dërgojnë informacion në INSTAT mbi Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore do të raportojnë ndryshime, ky informacion do të azhurnohet dhe publikohet në botimin e muajit pasardhës, shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit. Nuk janë kryer rishikime mbi “Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore” për vitin 2024, subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Për të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore, INSTAT përdor informacionin e siguruar nga “Anketa Mujore e Çmimeve të Produkteve Bujqësore”. Çmimet mblidhen në vendet më përfaqësuese në vend. Në kushtet e mungesës së një regjistri të fermave bujqësore dhe pikave të tjera grumbulluese të çmimeve bujqësore, përzgjedhja e këtyre njësive është realizuar nga specialistët e zyrave rajonale të statistikave në bashkëpunim me anketuesin e qarkut bazuar në instruksionet e përgatitura nga zyra qendrore e statistikave. Kriteri kryesor për përzgjedhjen e vendeve për mbledhjen e këtyre çmimeve janë: • Produktet që janë prodhime vendi në nivel ferme, • Produkte vendi jo importi, • Sasi jo më pak se 100 kg në ditën kur zhvillohet anketa. Kriteret e përzgjedhjes janë objekt përditësimi. Një herë në vit, zakonisht në Dhjetor përditësohet kampioni i fermave bujqësore dhe vendeve ku grumbullohen çmimet. Pyetëtori përbëhet nga 79 produkte bujqësore dhe 24 produkte blegtorale, pra 103 produkte në total. Ai është i ndarë në tre seksione: • Drithëra, Bimë Industriale, (gruri, theker, elb, tershere, miser kokerr, luledielli, duhan, foragjere etj).

	• Fruta, Perime(domate, kastravecë, specë, lulëlakër, spinaq, karota, patëllxhan, patate, qepe, molle, arra, portokall, limona, ullinj, rrush etj). • Produkte Blegtorale (gjedhi, te imtat, te dhirtat, derrat, pulat, vezët, mjalti, lesh etj).
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat për Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore mblidhen në baza mujore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Çmimet mblidhen çdo muaj më datë 15-30. Mbledhja e çmimeve bëhet në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 701/2006 lidhur me kohën e mbledhjes së çmimeve në Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore. Çmimet mblidhen nga anketuesit e anketave bujqësore të përzgjedhur posaçërisht për këtë vërtetim. Çmimet mblidhen me intervistë direkte duke përdorur pyetësin e dizenuar për këtë qëllim. Çmimet për çdo produkt mblidhen një herë në muaj në një datë të përcaktuar më parë nga zyra qendrore. Për disa produkte me frekuencë të lartë ndryshimi, si frutat dhe zarzavatet çmimet mund të mblidhen edhe dy apo tri herë në muaj dhe për llogaritje meret parasysh çmimi absolut i mbledhur. Skedari i ri i raportimit të çmimeve është projektuar për të lejuar anketuesin të regjistrojë specifikimet e detajuara të produktit. Çmimet mblidhen çdo muaj 3 çmime dhe 3 sasi të ndryshme të produkteve bujqësore dhe blegtorale në të gjithë rajonet e sipërpërmendura (pika 2.4) dhe dita që mblidhet ky informacion përkon me ditën e tregut në secilin qark. Për të siguruar marrjen e një informacioni sa më të saktë, përdoren edhe tregjet, thertoret, etj, ku pyeten fermeret për çmimin e këtyre produkteve. Vendet e grumbullimit të çmime mund të ndryshojnë. Kjo varet nga zhvendosjet e tregjeve të ndryshme si dhe krijimin e tregjeve ose fermerëve të rinj. Mbledhja e këtyre çmimeve bëhet vetëm për ato produkte që janë prodhime vendi në nivel ferme jo importi në sasi jo me pakse 100 kg në ditën kur zhvillohet anketa. Për të patur më të lehtë përzgjedhjen, anketuesit bashkëpunojnë me fermerin që shet produktete ose tregëtarin me shumicë. Është e domosdoshme që në çdo muaj të mblidhen çmimet për të njëjtin produkt. Nëse në javën në të cilën mblidhen çmimet nuk do të ketë prodhim për një produkt të dhënë, por ky produkt fillon prodhimin në javën e mëvonshme të dhënat do të mblidhen në javën më pas. Do të kryhen tre vërtetime për secilin produkt për çdo qark. Data e marrjes së çmimeve do të jete një ditë e mesit të muajit që përkon me ditën e tregut.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Të dhënat e raportuara nga zyrat rajonale kontrollohen nga zyra qendrore para se ato të përdoren për llogaritjen e treguesit. Kontrolli konsiston në: • Ndonjë hedhje gabim e njësisë matëse; • Hedhje gabim të çmimit të muajit aktual; • Ndryshimet e çmimeve të produkteve shoqërohen me shpjegimin përkatës.

	Një nga hapat e pastrimit dhe validimit të të dhënave është edhe imputimi i vlerave të munguara. Vlera e munguar imputohet duke përdorur tre rregulla: 1. Përsëritja e çmimit të fundit të grumbulluar; 2. Çmimi mesatar i produktit në muajin përkatës; 3. Ndryshimi mesatar i çmimit për të njëjtin produkt. Këto metoda përdoren si për produktet sezonale ashtu edhe për ato produkte që gjenden në treg gjatë gjithë vitit.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Çmimet e mbledhura nga anketuesit hidhen në një skedar tip excel të dizenuar për hedhjen mujore të çmimeve. Formatu u dizenua në vitin 2013 dhe lejon kryerjen e disa kontrolleve para raportimit të çmimeve nga zyrat rajonale në zyrën qendrore të çmimeve në INSTAT. Gjithashtu në pyetesor ka një kolonë ku raportohet arsyeja e ndryshimit të madh të çmimit krahasuar me muajin e mëparshëm. Këto shënime janë të rëndësishme për kryerjen e rregullimeve cilësore të nevojshme. Çmimi i muajit të kaluar është regjistruar në formatin e transmetimit dhe automatikisht llogaritet ndryshimi relativ i çmimit me muajin e kaluar. Te dhenat kryhen nga një operator pranë INSTAT dhe kontrollohen nga specialistët e sektorit të Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis. Skema e peshave në Indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore: Për llogaritjen e indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore përdoret edhe skema e peshave. Vlera e peshës bashkëngjitur në çdo indeks elementar dhe në indeksin e agreguar është e barabartë me vlerën e shitjes së produkteve (pa përfshirë TVSH) gjatë periudhës bazë (2015=100), bazuar kjo në metodologjinë ndërkombëtare. Peshat përdoren gjithashtu dhe për të bashkuar nëngrupet e indekseve në nivel grupi dhe për të bashkuar indekset në nivel grupi me totalin. Peshat e çmimeve të produkteve bujqësore konform parimeve të Llogarive Ekonomike në Bujqësi (në konceptin e çmimeve të prodhimit). Peshat totale dhe peshat tremujore të këtyre çmimeve janë fikse gjatë periudhës bazë. Skema e peshave për Indeksin e Çmimeve Bujqësore ndryshon çdo 5 vite. Llogaritja e indeksit elementar të Çmimeve: Indeksi elementar llogaritet sipas formulae në vijim duke përdorur çmimet mesatare absolute. $R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^0} \cdot 100$ R_i^t: Indeksi elementar për muajin “t” dhe prodhimin “i” P : Çmimet e grumbulluara i : Prodhimi “i” j : Çmimi i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për rrethin 1,2,...,n) t : Muaji i vëzhguar o : Muaji bazë Llogaritja e indeksit të agreguar të Çmimeve: Indeksi të agreguar për totalin e prodhimeve ose nëngrupeve të indeksit të prodhimeve është llogaritur duke shfrytëzuar formulën në vijim: $I^t = \sum (R_i^t \cdot \frac{w_i^0}{\sum w_i^0}) \cdot 100$

	I : Indeksi i agreguar për periudhën “t” w_i^0 : Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin “i” i : Prodhimi “i” t : Muaji i vëzhguar o : Muaji bazë
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	